## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 te Ligjit nr. 04/L-042 per Prokurimin Publik te Republikes se Kosoves, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Nje ankese kunder: **MINISTRIA E SHENDETESISE**

Per Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **206-26-414-2-1-1**

Sa i perket tenderit per : **"Pastrimi i objektit te MSH-se, depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte"**

## ANKESE

### 1. Identifikimi i ankuesit*

**efa Dienstleistung GmbH Dega ne Kosove**

*(Sheno emrin e plote te kompanise suaj)*

**Rr: Rexhep Mala Aktash**

*(Adresa)*

*Prishtine* — *10000*

*(Vendi)* — *(Kodi postar)*

*049688820*

*(Numri Telefonit)* — *(Numri i Faks-it)*

*Meriton Bajrami*

*(Emri i plote i perfaqesuesit te kompanise suaj)*

**efagroupshpk@gmail.com**

*(Adresa elektronike)*

**01.06.2026**

*(Data e parashtrimit te ankeses)* — *(Nenshkrimi dhe vula)*

DIENSTLEISTUNG GMBH DEGA KOSOVË efagroupshpk@gmail.com www.efa-dienstleistung.de Rr. Rexhep Mala nr.25/ Aktash, 10000 Prishtinë

**Ankues do te thote nje pale e interesuar per parashtrim te ankeses.*

### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankeses mund ta parashtroj ankesen vetem ose permes avokatit te tij. Nese ankesa parashtrohet permes avokatit, atehere duhet bashkangjitur autorizimin e perfaqesimit me PROKURE.*

*Sheno te dhenat si ne vijim:*

______________________________
*(Emri i avokatit)*

______________________________
*(Adresa e plote)*

______________________________ ______________________________
*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

______________________________
*(Adresa elektronike)*

______________________________ ______________________________
*(Data e parashtrimit te ankeses)* *(Nenshkrimi dhe vula)*

## 3. Te dhenat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Sheno nje pershkrim te shkurter lidhur me daten dhe vendin ne te cilen eshte publikuar " Njoftimi per Kontrate" apo "Njoftimi per konkurs te projektimit" dhe, nese aplikohet "Njoftimi per dhenie te Kontrates", "Njoftimi per Rezultatet e Konkursit te Projektimit" apo "Njoftimi per anulim te aktivitetit te prokurimit", nese aplikohet, afatin e fundit per dorezimin e tenderit, daten dhe oren e fillimit te procesit per Hapjen e Tendereve, si dhe kriteri per dhenie te kontrates]:*

Njoftimi per kontrate 09.02.2026
Hapja e ofertave 06.03.2026
Kerkesa per qasje ne dokumentet e OE-ve 30.03.2026
Qasja ne dokumentet e OE-ve permes Email-it 30.03.2026
Njoftimi mbi rezultatin e aktivitetit te prokurimit 27.03.2026
Vendimi per pranimim e kerkeses per rishqyrtim 14.04.2026
Njoftimi mbi rezultatin e aktivitetit te prokurimit pas rivlersimit 15.05.2026
Kerkesa per qasje ne dokumentet e OE-ve 15.05.2026
Lejimi ne qasje ne dokumentet e OE-ve 18.05.2026
Kerkesa per rishqyrtim e dorzuar ne AK 20.05.2026
Refuzimi i kerkeses per rishqyrtim 22.05.2026
Referenca nga Ministria Shendetesis

## 4. Procesi i Hapjes se tendereve, *nese aplikohet*

*A keni marre pjese ne procesin e Hapjes se tendereve? Nese po, specifikoni shkurtimisht ecurine e procesit te Hapjes se Tendereve.*

**Po** [X] **Jo** [ ]

Ne rregull

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nese aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesemarrja e metutjeshme ne aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [X] **Jo** [ ]

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve**

*A keni bere kerkese per rishqyrtim prane AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** [X] **Jo** [ ]

| |
|---|
| *Nese po, ofroni detaje mbi kete fakt dhe bashkengjit nje kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarreveshjeve ne perputhje me nenin 108A te LPP-se.* |

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispoziten ose dispozitat e LPP-se qe supozohet te jene shkelur nga Autoriteti Kontraktues qe nga momenti i publikimit te Njoftimit per Kontrate/Konkurs te Projektimit, dhe nese aplikohet gjere ne permbylljen e ketij aktiviteti te prokurimit me publikimin e Njoftimit per Dhenien e Kontrates apo Njoftimit per Rezultatet e Konkursit te Projektimit apo Njoftimit per Anulim.*

Ligji nr 04/L-042, i amandamentuar.

Autoriteti Kontraktues (AK) ka shkelur dispozitat e Ligjit per Prokurimin Publik, konkretisht:

- Neni 7 – Barazia ne trajtim / Mosdiskriminimi
- Neni 28 – Specifikimet teknike
- Neni 31 – Ekzekutimi i kontratave
- Neni 59 – Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve
- Neni 69 - Aftesia Teknike dhe/ose Profesionale
- Neni 1-Qellimi, fusheveprimi

*** Sipas Nenit 118 te LPP, OSHP-ja do te kthej tarifen tuaj nese ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund te kerkoj nje gjobe shtese deri ne 5,000 Euro ne rastet kur OSHP-ja konstaton qe te gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara ne ankese kane qene te rrejshme ose mashtruese.*

**8. Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet**

*Pershkruani rrethanat faktike qe perbejne supozimin per shkeljen e dispozitave te LPP-se. Ofroni deklarate te qarte dhe te detajuar per faktet dhe argumentet te cilat mbeshtesin secilen baze te ankeses tuaj.*

Te nderuar,
Me daten 15.05.2026, juve si Autoritet Kontraktues – Ministria e Shendetsis, keni publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-se – Formularin B58, ku keni rekomanduar per dhenie te kontrates Grup i Operatoreve Ekonomik GUARD DE CAPITAL SH.P.K.; Pro Tech Clean SH.P.K., Rruga B Objekti 2, Hyrja 1 nr 49, 10000, Prishtine.perderisa oferten tone e keni eleminimuar me arsyetimin si me poshte:

Ne si OE ankues bazuar ne afatin ligjore te parapare me nenin 108A/A te LPP-se me poshte paraqet kunder argumentet dhe shkeljet ligjore te konsumuara nga ju si AK :

Si perfundim ne si OE, pervec inicimit te procedurave tjera, shkeljet ligjore dhe mos konsistencen e vleresimeve, prandaj, bazuar ne prova dhe deshmi.
Kundershtojme rivleresimin e bere nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Shendetsis , pasi konsiderojme se i njejti eshte ne kundershtim me kerkesat dhe kriteret e percaktuara ne Dosjen e Tenderit.

Autoriteti Kontraktues, gjate rivleresimit, ka shtuar elemente dhe pritshmeri te cilat nuk kane qene te percaktuara si kerkesa specifike ne Dosjen e Tenderit, perkatesisht lidhur me menyren e kalkulimit te zevendesimeve te punetoreve gjate pushimeve vjetore. Meqenese nje kerkese e tille nuk eshte parapare si kerkese ne Dosjen e Tenderit, e njejta nuk mund te perdoret me pas si baze per refuzimin e ofertes sone.

Lidhur me piken 2.3 te Dosjes se Tenderit, sqarojme se kjo dispozite percakton nje obligim te pergjithshem te Ofruesit te Sherbimeve per te siguruar vazhdimesine e sherbimit dhe numer te mjaftueshem te punetoreve gjate gjithe kohes, pavaresisht nga pushimet vjetore, pushimet mjekesore apo obligimet tjera ndaj punetoreve. Ne si kompani punojme duke repsektuar dhe duke qene ne harmoni te plote me ligjin e punes, duke ju mundesuar qe te gjithe punonjesit e kompanise sone t'i shfrytezojne pushimet vjetore mjeksore dhe duke respektuar te gjitha te drejtat tjera sic i parasheh ligji i punes.

Megjithate, kjo pike nuk percakton ndonje metodologji te veçante te kalkulimit financiar, nuk kerkon paraqitjen e nje kalkulimi te posaçem per zevendesime dhe nuk parasheh qe operatori ekonomik duhet te deshmoje ne oferte nje numer shtese te punetoreve per periudhat e pushimeve. Prandaj, Autoriteti Kontraktues nuk mund ta interpretoje kete dispozite si kriter shtese per refuzimin e ofertes, duke pretenduar se oferta jone nuk eshte reale apo kualitative.

Kompania jone ka marre persiper plotesisht obligimin qe gjate gjithe periudhes se kontrates te siguroje punetore te mjaftueshem per realizimin e sherbimeve, perfshire edhe rastet e pushimeve vjetore, pushimeve mjekesore apo mungesave te tjera te punetoreve. Ky obligim eshte pjese e organizimit te brendshem te kompanise dhe nuk nenkupton automatikisht se oferta jone eshte jo-reale apo financiarisht e paqendrueshme.

Theksojme se kompania Efa Dienstleistung GmbH – Dega ne Kosove operon ne treg dhe ofron sherbime te kesaj natyre per institucione publike qe nga viti 2021. Gjate kesaj periudhe, kompania jone ka ofruar sherbime cilesore, ka permbushur me pergjegjesi kontratat e saj dhe nuk ka deshtuar asnjehere ne realizimin e obligimeve kontraktuale apo ne permbushjen e obligimeve ndaj punetoreve.

Prandaj, pretendimi i Autoritetit Kontraktues se oferta jone nuk eshte reale, bindese apo kualitative per realizim, eshte i pabazuar dhe nuk mbeshtetet ne prova konkrete, por ne supozime dhe ne nje interpretim te zgjeruar te Dosjes se Tenderit. Ne kemi kalkuluar pagat e punonjesve sipas vendimit 10/273 per pagen minimale qe eshte 500 EUR bruto, ndersa ne kemi kalkulu total koston e kompanis 525*7*12=132,300.

Per shkak te pervojes se gjate, organizimit te brendshem efikas, menaxhimit profesional te stafit, furnizimit me materiale me cmime shumice dhe rezerva te mjaftueshme operative, kompania jone eshte plotesisht ne gjendje te realizoje kontraten sipas kerkesave te dosjes tenderit dhe legjislacionit ne fuqi.

Gjithashtu, si deshmi shtese, deklarojme se kompania jone permbush me rregull dhe brenda afateve ligjore te gjitha obligimet ndaj punonjesve, perfshire pagat, kontributet dhe detyrimet tjera te parapara me legjislacionin ne fuqi. Po ashtu, konfirmojme se kompania nuk ka asnje obligim te papaguar ndaj institucioneve tatimore dhe eshte ne gjendje te rregullt tatimore.(deshmi per kete kemi bashkengjitur vertetimin tatimor nga adminsitratat tatimore).

Perkunder pretendimit se oferta jone nuk eshte reale dhe nuk garanton realizim cilesor te kontrates vete AK ka leshuar reference pozitive per realizimin e kontrates paraprake, per te njejtat sherbime, duke konfirmuar kenaqesin me performancen dhe cilesin e sherbimve te ofruara, dhe referenca pozitive e leshuar nga Ministria e shendetesis bie ndesh me pretendimin se oferta nuk garanton realizim cilesor.

Me poshte eshte referenca nga AK te cilet mund ta beni nje vleresim objektiv.

Per keto arsye, kerkojme qe rivleresimi i bere nga Autoriteti Kontraktues te anulohet dhe oferta jone te trajtohet ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne Dosjen e Tenderit, si dhe me parimet e trajtimit te barabarte, transparences dhe mosdiskriminimit te operatoreve ekonomike.

**Dispozitat e shkelura**

- **Neni 7 – Barazia ne trajtim/Mosdiskriminimi**

Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundershtim me Nenin 7 te Ligjit per Prokurimin Publik, i cili garanton trajtim te barabarte, jo-diskriminues dhe transparent per te gjithe operatoret ekonomike.

Ne rastin konkret, vendimi i Autoritetit Kontraktues eshte diskriminues, pasi qe eliminon nje operator ekonomik i cili ka permbushur te gjitha kerkesat e percaktuara ne dosjen e tenderit, nderkohe qe shpall fitues nje operator ekonomik tjeter me çmim me te larte.

Ky veprim bie ndesh me parimin e konkurrences se drejte dhe efikasitetit ne shpenzimin e fondeve publike, duke favorizuar padrejtesisht nje operator ekonomik dhe duke demtuar interesin publik.

Per rrjedhoje, kerkojme rishqyrtimin e ketij vendimi dhe rivleresimin e ofertave ne perputhje me parimet themelore te prokurimit publik.

**2.1 Neni 28 – Specifikimet teknike**

AK eshte i obliguar qe te percaktoje qarte dhe ne menyre te plote te gjitha specifikimet teknike ne dosjen e tenderit.

Ne rastin konkret:

- AK nuk ka parashtruar kerkese per kalkulimin e pushimeve vjetore apo zevendesimeve specifikisht.

Ne Aneksin 1 te dosjes se tenderit eshte kerkuar vetem qe:

"Ofruesi i sherbimeve duhet te kete punetore te mjaftueshem pavaresisht nga obligimet ndaj punetoreve (pushime vjetore, pushime mjekesore, etj.)"

Kjo kerkese:

- Nuk eshte e njejte me kerkesen per kalkulim te pushimeve/zevendesimeve
- Le pergjegjesine tek Operatori Ekonomik per organizimin e brendshem, jo per kalkulim te detyrueshem ne oferte

Ne kemi permbushur kete kerkese permes deklarates perkatese, ashtu siç eshte kerkuar ne dosjen e tenderit.

Kompania jone ka dorezuar deklarate te nenshkruar, me te cilen eshte zotuar se do te permbushe te gjitha obligimet ligjore qe rrjedhin nga Ligji i Punes dhe legjislacioni ne fuqi, perfshire:

pagesen e pagave ne perputhje me pagen minimale

pagesen e kontributeve dhe tatimeve

respektimin e te gjitha obligimeve ndaj punetoreve

Siç deshmohet ne Figuren 1 me poshte, kompania jone eshte zotuar shprehimisht per permbushjen e ketyre obligimeve.

**Për:** Ministria e shëndetsisë
**Lënda:** Pastrimi i objektit të MSH-së, depos së barnave dhe objektit i tri inspektoriateve dhe DSHB në Lakrishte
**Nga:** Kompania efa Dienstleistung GmbH Dega në Kosovë
**Datë:** 06.03.2026, Prishtinë

Kompania jonë deklaron se pajtohet dhe zotohët se do i përmbushë të gjitha kërkesat ligjore të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues Ministria e shëndetsisë për aktivitetin më të dhënat numëri i prokurimit: 206-26-414-2-1-1 me titull: Pastrimi i objektit të MSH-së depos se barnave dhe objektit I tri inspektoriateve dhe DSHB në Lakrishte TË MINISTRISË SHËNDËTSISË.

Kompania jonë deklaron se do ti paguan të gjithë punëtorët konform ligjit të punës në fuqi (jo me pak se 456.50 euro Neto si page minimale e përcaktuar sipas ligjeve në fuqi dhe Vendimit te Qeverise se RK nr. 10273 te datës 31.10.2025), Ofruesi i shërbimeve duhet te lidh kontrate me secili punëtore dhe te kryen pagesën e të gjitha kontributeve në Administratën tatimore të parapara me ligje te Republikës se Kosovës.

Kompania jonë deklaron se punëtoreve do tua paguaj pagën min. 456.50 euro Neto (bazuar ne Vendimin e Qeverise se RK nr. 10273 te datës 31.10.2025 për pagën minimale 500 euro Bruto), si dhe te gjitha kontributet dhe tatimet duke përfshirë edhe TVSH, ne harmoni me Ligjin e Punës në fuqi.

Kompania efa-dienstleistung GmbH-Dega në Kosovë
Meriton Bajrami
Drejtor

## 2.2 Neni 31 – Ekzekutimi i kontrates

AK mund te vendose kushte per ekzekutimin e kontrates, por:

- keto duhet te jene te perfshira ne dosjen e tenderit

Ne kete rast:

- Edhe pse ka pasur kerkesa per sqarime, AK ne asnje moment nuk ka kerkuar kalkulim te pushimeve
- Ne kemi dorezuar deklaraten per perputhshmeri teknike sipas kerkeses:

"OE duhet te plotesoje deklaraten per perputhje me specifikat teknike ne Aneksin 1"

Eliminimi yne me arsyetimin per mungese kalkulimi:

- eshte i pabazuar dhe ne kundershtim me kerkesat e tenderit

2.3 Standardet e dyfishta

- Autoriteti Kontraktues ka perdorur te njejtat specifikime teknike edhe ne proceduren e prokurimit te vitit 2022, ku ne Aneksin 1 eshte parapare kerkesa:

Ofruesi i sherbimeve duhet te kete punetore te mjaftueshem gjate gjithe kohes, pavaresisht nga obligimet ndaj punetoreve (pushime vjetore, pushime mjekesore, etj.)

Ndryshimi i interpretimit te se njejtes kerkese perben trajtim te pabarabarte dhe standard te dyfishte

**Pjese e shkeputur nga dosja e tenderit e vitit 2022:**

**Kompania jone ka qene fituese ne kete procedure dhe ka realizuar kontraten per nje periudhe 3-vjeçare ne perputhje te plote me kerkesat e AK.**

**Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

## 1. PASTRIMI I OBJEKTEVE

Autoriteti Kontraktues (Ministria e Shëndetësisë) është duke identifikuar ofruesin e shërbimeve që do të ketë kapacitetin për të kryer shërbimet e pastrimit për Ministrinë e Shendesise.

### 1. SQARIME PËR TERMET E PËRDORURA

Me termin "MIREMBAJTA DHE PASTRIM I OBJEKTIT TE MSH-së" nënkuptohet realizimi i të gjitha punëve të nevojshme lidhur me pastrimet – mirëmbajtjen e higjienës në ndërtese në mënyrë që të përmbushen kërkesat për zbatimin e ligjit mbi mbrojtjen në punë me të cilat duhet krijuar kushtet normale për punë të shfrytëzuesve të hapësirave në kuadër të ndërtesës.

Mirëmbajtja higjienike përfshinë realizimin e punëve për:

- Mirëmbajtjen e pastërtisë në të gjitha hapësirat e brendshme te ndërtesës
- Mirëmbajtjen e shtigjeve të këmbësorëve si dhe të parkingjeve të automjeteve
- Mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara
- Largimin e mbeturinave – nga ndërtesa deri te kontejnerët qendrorë për mbeturina
- Bartjet e materialeve, inventarit etj brenda ne ndërtesa

### 2.PLANI I ORGANIZIMIT TË KRYERJES SË SHERBIMEVE TE PASTRIMIT - OBLIGIMET

2.1 Në planin e organizimit te Ofruesit te shërbimeve duhet patjetër të përfshihet edhe numri minimal i kryeseve të secilit profil, te udhëhequr nga Menaxheri i Ofruesit te shërbimeve.

2.2 Punëdhënësi ka te drejt dhe obligim të kontrolloi dhe kërkoj rritjen e cilësisë se ofruar te shërbimeve dhe nëse vlerëson se me punëtorët aktual nuk arrihet ofrimi i shërbimeve cilesore, Ofruesi i shërbimeve obligohet qe të merr masat e duhura qe te rrit cilësinë e shërbimeve te ofruara.

2.3 Ofrues i shërbimeve gjate gjithë kohës duhet të ketë punëtorë të mjaftueshëm pavarësisht nga obligimet e Ofruesit te shërbimeve ndaj punëtorëve të tij ( Pushime vjetore, pushimet mjekësorë, .......etj. ).

2.4 Ofruesi i shërbimeve për çdo javë do të dorëzoj specifikimin e materialit të shpenzuar për realizmin e shërbimeve.

2.5 Ofruesi i shërbimeve duhet te mbajt historikun për punët e kryera, duke u bazuar në punët e kryera sipas kërkesave, planeve, ditarit të punës dhe ditarin e kujdestarisë.

2.6 Ofruesi i shërbimeve obligohet që dy deri tri ditë para se të filloi muaji i ri, përmes shkresës zyrtare të dorëzoj

---

2.4 Neni 59 – Vleresimi i tendereve

Sipas ketij neni:

- Nuk lejohet ndryshimi i kushteve materiale gjate vleresimit

Ne kete rast:

- AK ka vendosur nje kriter te ri (kalkulimi i pushimeve) gjate vleresimit
- Ky kriter nuk ka qene ne dosjen e tenderit

Kjo perben:

- ndryshim te aspektit material te tenderit
- shkelje te drejtperdrejte te ligjit

---

2.5 Neni 60 – Kriteri per dhenien e kontrates

AK ka percaktuar kriterin:

“Tenderi i pergjegjshem me çmimin me te ulet”

Megjithate:

- Oferta jone:
  - ishte me e uleta ne çmim
  - ishte plotesisht e pergjegjshme
  - permbushte te gjitha kerkesat teknike dhe administrative

Pavaresisht kesaj:

- AK ka shpallur fitues nje operator me çmim me te larte

Kjo perben:

- shkelje direkte te Nenit 60

---

3. Argumentet faktike dhe ekonomike

- Kompania jone operon qe nga viti 2020
- Ka realizuar kontrata vetem me institucione publike
- Ka permbushur te gjitha kontratat ne perputhje te plote me kerkesat
- Oferta jone eshte pergatitur ne perputhje te plote me dosjen e tenderit
- Kemi referencen(deshmin nga MSH) se te njejtin sherbime e kemi realizuar me sukses ne te njejtin institucion.

4. Kerkesa (Konkluzioni)

Duke u bazuar ne faktet dhe dispozitat e shkelura, kerkojme:

- Rivleresimin e tenderit ne perputhje me Nenin 60 dhe kriterin “çmimi me i ulet”
- Anulimin e vendimit per elimininimin tone
- Shpalljen e ofertes sone si fituese, ne perputhje me ligjin dhe dosjen e tenderit

---

**VENDIM**

I. **Te aprovohet** ne teresi kerkesa per ri shqyrtim si e bazuar

II. **Te kthehet** lenda ne ri vleresim dhe

Duke u bazuar ne faktet dhe dispozitat e shkelura, kerkojme nga Paleli shqyrtues i OSHP-se qe te merr kete vendim:

- **Rivleresimin e tenderit** ne perputhje me Nenin 60 dhe kriterin “çmimi me i ulet”
- **Anulimin e vendimit per elimininimin tone**

**Shpalljen e ofertes sone si fituese**, ne perputhje me ligjin dhe dosjen e tenderit

| |
|---|
| |

**9. Demet materiale**

*Pershkruaj menyren se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kercenohet t'i shkaktoje deme materiale parashtruesit te ankeses, ne rast se perfshini pretendime per kompensim.*

Si rezultat i vendimit te paligjshem, kompania jone ka pesuar:

- Humbje te drejtperdrejta financiare
- Humbje te te ardhurave te pritshme nga kontrata
- Pengim te zhvillimit te aktivitetit ekonomik
- Kosto administrative te pergatitjes se ofertes

Cenim te konkurrences se ndershme

**10. Lista e dokumenteve (deshmive) te bashkangjitura**

*Nese aplikohet, bashkengjitni Ankeses dokumentet e renditura me poshte:*

*a) nje kopje te publikimit te "Njoftimit per Kontrate" apo "Njoftimit per Konkurs te Projektimit.*
*b) nje kopje te publikimit per "Njoftimin e Dhenies se Kontrates" apo "Njoftimin per Rezultatet e Konkursit te Projektimit" apo "Njoftimit per Anulim".*
*c) nje kopje te letres se eliminimit te tenderuesit/kandidatit/ letres se tenderuesit te pasuksesshem/ letres per mos para-kualifikim.*
*d) nje kopsje te procesverbalit te hapjes publike te tendereve, nese aplikohet,*
*e) bashkengjit nje kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarreveshjeve ne perputhje me nenin 108A te LPP-se,*
*f) Deshmine e pageses se tarifes se ankimit ne perputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
*g) te gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke perfshire e-mailat si dhe çdo informate te shkruar qe ka te beje me kete aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim te paraqitur ne ankese.*
*h) Leter Referenca e leshuar nga Ministria e shendetesis per sherbimet e pastrimit te ofruara nga kompania efa Dienstleistung GmbH Dega ne Kosove*

****Sipas Nenit 111.2 te LPP, Parashtruesi i ankeses, origjinalin e ankeses do t'ia dorezoje OSHP-se dhe njekohesisht nje kopje do t'ia dergoje ne menyren me te shpejte te mundshme Autoritetit Kontraktues.*

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

# NJOFTIM PËR KONTRATË

☐ *PUNË* ☐ *FURNIZIM* ☒ *SHËRBIME*

*Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

**Data e përgatitjes së njoftimit: 09.02.2026**

| | |
|---|---|
| **Nr i Prokurimit** | **206-26-414-2-1-1** |
| **Nr i brendshëm** | |

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☒

## NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|---|---|---|
| **Emri zyrtar: MINISTRIA E SHËNDETËSISË** | | |
| **Adresa Postare: ZAGREBIT , P.N.** | | |
| Qyteti: **PRISHTINË** | Kodi postar: **-** | Vendi: **Kosovë** |
| **Personi kontaktues: Besim Bajraktari** | | Telefoni: **+383 20024038** |
| Email: **besim.bajraktari@rks-gov.net** | | Faksi: |
| Adresa e Internetit (*nëse aplikohet*): | | |

Po ☐ Jo ☒

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

***Nëse po***, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

## NENI II: LËNDA E KONTRATËS

### II.1) PËRSHKRIMI

**II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:**
**"Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte"**

**II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit**
*(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)*

| ☐ **Punë** | ☐ **Furnizime** | ☒ **Shërbime** |
|---|---|---|
| ☐ Ekzekutim<br>☐ Plani dhe ekzekutimi<br>☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa | ☐ Blerja<br>☐ Qira financiare (lizing)<br>☐ Qira<br>☐ Blerje me këste<br>☐ Një kombinim i këtyre | |

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
**" MSH-së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte"**

**II.1.3) Njoftimi përfshinë**

Krijimin e kontratës publike kornizë
☒

**II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë** *(nëse aplikohet):*

Kontrate publike kornizë me një operator
☒

Kontrate publike kornizë me disa operator
☐

**Ekzekutimi i kontratës:**

Thirrje/Porosi
☒

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë
☐

**Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj 36**

**II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës**
**"Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte"**

**II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):**

**93000000-8**

**II.1.7) Variantet pranohen**

Po ☐ Jo ☒

**II.1.8) Ndarja në Pjesë**

Po ☐ Jo ☒

*Nëse po,* tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

**II.1.9) Informacione lidhur me pjesët** *(nëse aplikohen)*

| Nr. i pjesës | Emërtimi i grupit | Përshkrimi i shkurtër |
|---|---|---|
| | | |

**Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:**

**II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 180,000.00**

## II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

**Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm** *(përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)*

**Sipas listes se qmimeve**

## II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj apo ditë (nga dhënia e kontratës)

*apo*

Fillimi

Përfundimi

## NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

## III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

**III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit**

Po ☒ Jo ☐

*Nëse po,* vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose **10% e vleres se kontrates per periudhen 37 muaj** % e vlerës së kontratës

**III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata** *(nëse aplikohet)*:

**III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës**

| |
|---|
| Po ☐ Jo ☒ <br><br> *Nëse po,* përshkrimi i kushteve të veçanta |

## III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

| III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
|---|---|
| **Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rks-gov.net** | **Dëshmia 1. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2. a. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës - kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. b. Dëshmi se operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk është shpallur fajtor lëshuar nga Gjykata - kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, (a) dhe (b), i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është B05 Njoftim per Kontrat 5 11 rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe.** |
| III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| **Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve ne vendin e juaj te themelimit.** | **Dëshmia 1. Kopje e Certifikatës se regjistrimit te biznesit, me informacione te biznesit (Numri Unik Identifikues)** |
| **Kërkesa 2. Certifikata për TVSH për secilin partner te një grupi operatoresh ekonomik – kjo vlen vetëm për kompanitë e regjistruara ne Kosove.** | **Dëshmia 2. Kopje e Certifikatës se TVSH-se.** |
| III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| **Kërkesa 1 OE ose GOE duhet të dëshmoj se ka** | **1. - Një listë te shërbimeve të realizuara ku** |

| | |
|---|---|
| realizuar me sukses shërbime te ngjashme ne vlere min. 150,000.00 euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare nga data e Njoftimit për Kontratë. | duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te shërbimeve. Kur shërbimet janë kryer për një blerës privat, për dëshmi të kryerjes së shërbimeve shërben dëshmi e pranimit të shërbimeve si dhe transaksionet bankare. |
| Kërkesa 2 OE ose GOE duhet te deklarohet se punëtoreve do tua paguaj pagën min.500 euro Neto, si dhe te gjitha kontributet dhe tatimet duke përfshirë edhe TVSH, ne harmoni me Ligjin e Punës në fuqi. Pagat a punëtorëve do te paguaj për muajin paraprak, me sa largu deri me date 05 te muajit ne vijim. | 2. Deklarata e nënshkruar dhe vulosur nga OE se do te paguaj pagat min. 500 euro Neto, si dhe te gjitha kontributet dhe tatimet duke përfshirë edhe TVSH, ne harmoni me Ligjin e Punës në fuqi. Për muajin paraprak, me sa largu deri me date 05 te muajit ne vijim. |
| Kërkesa 4 OE ose GOE duhet të plotësoj Deklaratën për përputhje te specifikave teknike te shërbimeve dhe materialeve, me kërkesat e AK ne Aneksin 1. | 4. Deklaratën për përputhje te specifikave teknike te shërbimeve dhe materialeve, me kërkesat e AK ne Aneksin 1. |
| Kërkesa 5 OE ose GOE duhet të posedoj me mjete te nevojshme te punës - Një (1) Automjet për bartje te materialit hixhienik (Kombi ose Pick up); - Një (1) makine për thithjen e ujit; - Një (1) makine për pastrimin dhe lustrimin e dyshemesë; - Pesë (5) karroca për pastrimin e zyrave; Tre (3) makina për thithjen e pluhurit; | 5. Dokumentacion për dëshmi te pronësisë se pajisjeve te kërkuara. |

## III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

Po ☐ Jo ☒

**III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar**

*Nëse po,* referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

**III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve**

Po ☐ Jo ☒

## NENI IV: PROCEDURA

## IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

**IV.1.1) Lloji i procedurës**

☒ E hapur

☐ E kufizuar

☐ Konkurruese me negociata

☐ Kuotim i Çmimit

**IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim** *(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)*

Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme

të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për proceduren e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

**IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave** *(procedurë konkurruese me negociata)*

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

**Po** ☐ **Jo** ☐

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë
kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

**Po** ☐ **Jo** ☐

**IV.1.4 Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë Tenderët fillestar është:**

**IV.1.5. Informata ne lidhje me ankandin elektronik**

Do te përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒

Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik:

## IV.2) KRITERET E DHËNIES

☒ **Çmimi më i ulët**

*ose*

☐ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të**

## IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

**IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë**

**Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po,***

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (*nëse aplikohen):*

i

i

**Po** ☐ **Jo** ☒

Dokumentet me pages

***Nëse po,*** çmimi EUR

Kushtet dhe metoda e pagesës:

| |
|---|
| **IV.3.2) Afati i fundit për pranim të *tenderëve / aplikacioneve:***<br><br>*data* **02.03.2026** *koha* **14:00:00** *vendi* **E-Prokurim** |
| **IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e *tenderëve / aplikacioneve* është shkurtuar:**<br>☒ **Po** ☐ **Jo**<br><br>***Nëse po,*** jep arsyetim **Kontrata aktuale eshte ne përfundim dhe rrezikojme te mbesim pa shërbim, andaj eshte shume me rendesi qe sa me shpejte te arrijme ta kontraktojme.** |
| **IV.3.4)** A është e nevojshme siguria e tenderit:<br>Po ☐ Jo ☒<br><br>***Nëse po***, vlera e sigurisë së tenderit<br>Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë *apo* muaj |
| **IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:**<br>Deri më: data: ditët **90** apo muajt |
| **IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:**<br><br>**data 02.03.2026 koha 14:00:00 vendi E-Prokurim** |

## NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

### V.1) ANKESAT

| |
|---|
| **Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.** |

### V.2) INFORMACIONET SHTESË

| |
|---|
| **Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.**<br>*Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj)* |

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurment Division

# NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

*Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik*

Titulli i kontratës i dhënë nga AK: **"Pastrimi i objektit te MSH-së, depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte"**

| | |
|---|---|
| Nr. i prokurimit | **206-26-414-2-1-1** |

| Nr. | **Emri dhe adresa Operatorit Ekonomik pjesëmarrës** | Kodi i tenderit | **Vlera totale e ofertave** |
|---|---|---|---|
| 1 | Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë, Rexhep Krasniqi PN, 10000, Prishtin | MSH/06/03/26 | 157,704.06 € |
| 2 | Grup i Operatorëve Ekonomik CPS Phoenix Group L.L.C.; MEB L.L.C., Edit Durham, 20000, Prizren | 0603-26 PHX | 168,171.55 € |
| 3 | Grup i Operatorëve Ekonomik ShineUp Clean SH.P.K.; CAPITAL X FET SH.P.K., DËSHMORËT E KOMBIT, 2, 32000, Kline | MSH001 | 160,409.87 € |
| 4 | Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosovë Dega në Kosovë, "NENA TERZE", 13000, GLLOGOC | Ministria e Shendetesise/06.03.2026 | 177,148.41 € |
| 5 | ERIK SH.P.K., Dardani SU 6/5 C1 Nr.07, 10000, Prishtine | MSH/Pastrimi/03-2026 | 173,113.19 € |
| 6 | Grup i Operatorëve Ekonomik GUARD DE CAPITAL SH.P.K.; Pro Tech Clean SH.P.K., Rruga B Objekti 2, Hyrja 1 nr 49, 10000, Prishtine | MSH-06032026 | 172,041.96 € |
| 7 | INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K., Rr.Garibaldi, 10 000, Prishtin | IGB/MSH-26 | 162,864.94 € |
| 8 | DOUBLE I&I SH.P.K., Prishtinë, 10 000, Prishitin | MSH/2026 | 156,838.75 € |
| 9 | , UNI PROJECT SH.P.K., Rruga Rexhep Krasniqi pn, 10000, Prishtine | 206-26-414-2-1-1 | 177,536.02 € |
| 10 | Grup i Operatorëve Ekonomik ADRA GROUP CONSTRUCTION SH.P.K.; DARDANIAA SH.P.K., RR/ Enver Maloku, 21, Prishtinë | 06.03.2026 | 161,368.20 € |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 11 | E-Commerce -Kosova SH.P.K., Rr.Luan Haradinaj, 10000, Prishtinë | EC2026 | 176,148.06 € |
| 12 | Grup i Operatorëve Ekonomik ALLTON SH.P.K.; AROMA PLUS SH.P.K., Rruga Muharrem Fejza nr 4, 10000, Prishtine | 2026/ALLTON | 173,524.36 € |
| 13 | "KRASNIQI"SH.P.K., Isa Boletini -Ulpiana P+8/2 Nr. 47, -, PRISHTINË | KRASNIQI/MSH | 174,803.26 € |
| 14 | LAGUNA SH.P.K., Vllezrit Fazliu nr 385, 10000, PRISHTINË | 206-26-414-2-1-1 | 179,821.70 € |
| 15 | Grup i Operatorëve Ekonomik KIGA SH.P.K.; CRYSTAL CLEAR SH.P.K., Sllatine e Madhe, 12000, Fushe Kosove | 206-26-414-2-1-1 | 168,862.69 € |
| 16 | Grup i Operatorëve Ekonomik LEDI SH.P.K.; International Security AAH SH.P.K., ramadan rexhepi, 7, ferizaj | 3233 | 169,566.96 € |

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Ministria e Shëndetësisë **shpërblen** me kontratë Grup i Operatorëve Ekonomik **GUARD DE CAPITAL SH.P.K.; Pro Tech Clean SH.P.K.,** Rruga B Objekti 2, Hyrja 1 nr 49, 10000, Prishtine, me çmimin e ofertës (me TVSH) **172,041.96 €.**

Data: 15.05.2026

Emri dhe mbiemri i ZPP: **Berat Marmullaku**

Ketij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde te njoftimeve: B42, B45 dhe B46.( shtoni letra njoftuese sipas nevojes).

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurment Division

## B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar[1]

15.05.2026, Prishtinë

**Ministria e Shëndetësisë** – rr. e Zagrebit nr. 60, ish spitali i mushkërive, lagja Arbëria

**Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë, Rexhep Krasniqi PN, 10000, Prishtin**

| | |
|---|---|
| Nr. i prokurimit | **206-26-414-2-1-1** |

Titulli: **"Pastrimi i objektit te MSH-së, depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte"**

I nderuar z. Meriton Bajrami,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

ARSYETIM

Nuk i keni plotësuar kriteret siç janë kërkuar ne NJK dhe DT.

• Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

- Çmimi i ofruar sipas Analizës financiare nuk eshte bindes për AK dhe nuk mbulon te gjitha kostot reale te parapara me legjislacionin ne fuqi dhe me Vendimin e Qeverise se RK nr. 10273 te datës 31.10.2025 për pagën minimale 500 euro Bruto.

  Nuk i ka përfshirë pushimet vjetore sipas Ligjit te Punës nr 03/L-212 neni 32 paragrafi 1. Sipas Ligjit te Punës secilit punëtor ne vit i takon pushimi vjetor prej katër jave ose rreth një muaj, nga kjo rezulton se për një (1) punëtor brenda një viti shtohet kostoja edhe për 176 ore pune qe duhet te zëvendësohet nga një punëtor tjetër. Për shtate (7) punëtor përllogaritja eshte 7*176 = 1232 ore pune ne vit janë kosto shtese e pushimeve te punëtoreve, e te cilat duhet te mbulohen nga punëtore tjerë. Ndërsa për 3 vite te kontratës përllogaritja eshte 1232*3 = **3696 ore pune te pushimeve.**

  Vlera e parashikuar ne Dosje te Tenderit ka qene **180,000.00** Euro , ndërsa oferta Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë ne vlerën **157,704.06** Euro nuk paraqet oferte reale dhe kualitative për realizim.

[1] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojës).*

**Sqarim shtesë:** AK-MSh ka përvoja jo te mira pikërisht me kontratat e shërbimeve te ngjashme (pastrim dhe sigurim fizik) për te cilat kompanitë e kontraktuara me vështirësi po arrijnë qe ti realizojnë obligimet ndaj punëtoreve, andaj konsiderojmë qe një kontrate me çmimin 157,704.06 euro do te ishte e pa favorshme dhe vështirë e realizueshme për te dyja palët.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

_______ **Berat Marmullaku** ________,
*(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)*

*(Nënshkrimi)*

# PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

| Numri i prokurimit<br>Procurement number<br>Broj nabavke: | 206-26-414-2-1-1 | Titulli i Kontratës<br>Contract Title<br>Naslov ugovoru | "Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte" |
|---|---|---|---|
| Numri i brendshëm<br>Internal No<br>Interni broj | | | |

| Data e lëshimit<br>Date of issue<br>Datum izdavanja | Data e mbylljes<br>Closing date<br>Datum zatvaranja & Čas | Data e hapjes & Ora<br>Opening date & time<br>Datum Otvaranja & Čas | Vendi<br>Place<br>Mesto | Nr. i tenderëve të pranuar<br>No. of Received Tenders<br>Br. Primljenih Tendera |
|---|---|---|---|---|
| **06.03.2026** | **06.03.2026, 14:00:00** | **06.03.2026, 14:00:00** | **E-Prokurim** | **16** |

| Nr.<br>Br. | Tenderuesi<br>Tenderer<br>Tenderer | Kodi i tenderit<br>Tender label /code<br>Oznaka ponude | Pjesë<br>Lot<br>Lot | e-tenderit<br>e-tender<br>e-ponuda | Çmimi<br>Price<br>Cena<br>€ | Çmimi (me TVSh)<br>Price (with VAT)<br>Cena (sa PDV)<br>€ | Ndryshimi/plotësimi<br>Suplement/Amendment<br>Dpuna/Izmjena |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | **Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë, Rexhep Krasniqi PN, 10000, Prishtin** | **MSH/06/03/26** | **"Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte"** | **PO** | **133647.51** | **157704.06** | **JO** |
| 2. | **Grup i Operatorëve Ekonomik CPS Phoenix Group L.L.C.; MEB L.L.C., Edit Durham, 20000, Prizren** | **0603-26 PHX** | **"Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte"** | **PO** | **142518.27** | **168171.55** | **JO** |
| 3. | **Grup i Operatorëve Ekonomik ShineUp Clean SH.P.K.; CAPITAL X FET** | **MSH001** | **"Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se barnave dhe** | **PO** | **135940.56** | **160409.87** | **JO** |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | SH.P.K., DËSHMORËT E KOMBIT, 2, 32000, Kline | | objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte" | | | | |
| 4. | Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosovë Dega në Kosovë, "NENA TERZE", 13000, GLLOGOC | Ministria e Shendetesise/06.03.2026 | "Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte" | PO | 150125.77 | 177148.41 | JO |
| 5. | ERIK SH.P.K., Dardani SU 6/5 C1 Nr.07, 10000, Prishtine | MSH/Pastrimi/03-2026 | "Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte" | PO | 146706.09 | 173113.19 | JO |
| 6. | Grup i Operatorëve Ekonomik GUARD DE CAPITAL SH.P.K.; Pro Tech Clean SH.P.K., Rruga B Objekti 2, Hyrja 1 nr 49, 10000, Prishtine | MSH-06032026 | "Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte" | PO | 145798.27 | 172041.96 | JO |
| 7. | INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K., Rr.Garibaldi, 10 000, Prishtin | IGB/MSH-26 | "Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte" | PO | 138021.14 | 162864.94 | JO |
| 8. | DOUBLE I&I SH.P.K., Prishtinë, 10 000, Prishtin | MSH/2026 | "Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se | PO | 132914.19 | 156838.75 | JO |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte" | | | | |
| 9. | , UNI PROJECT SH.P.K., Rruga Rexhep Krasniqi pn, 10000, Prishtine | 206-26-414-2-1-1 | "Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte" | PO | 150454.25 | 177536.02 | JO |
| 10. | Grup i Operatorëve Ekonomik ADRA GROUP CONSTRUCTION SH.P.K.; DARDANIAA SH.P.K., RR/ Enver Maloku, 21, Prishtinë | 06.03.2026 | "Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte" | PO | 136752.71 | 161368.20 | JO |
| 11. | E-Commerce -Kosova SH.P.K., Rr.Luan Haradinaj, 10000, Prishtinë | EC2026 | "Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte" | PO | 149277.96 | 176148.06 | JO |
| 12. | Grup i Operatorëve Ekonomik ALLTON SH.P.K.; AROMA PLUS SH.P.K., Rruga Muharrem Fejza nr 4, 10000, Prishtine | 2026/ALLTON | "Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte" | PO | 147054.54 | 173524.36 | JO |
| 13. | "KRASNIQI"SH.P.K., Isa Boletini -Ulpiana P+8/2 | KRASNIQI/MSH | "Pastrimi I objektit te MSH- | PO | 148138.35 | 174803.26 | JO |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. 47, -, PRISHTINË | | së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte" | | | | |
| 14. | LAGUNA SH.P.K., Vllezrit Fazliu nr 385, 10000, PRISHTINË | 206-26-414-2-1-1 | "Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte" | PO | 152391.27 | 179821.70 | JO |
| 15. | Grup i Operatorëve Ekonomik KIGA SH.P.K.; CRYSTAL CLEAR SH.P.K., Sllatine e Madhe, 12000, Fushe Kosove | 206-26-414-2-1-1 | "Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte" | PO | 143103.97 | 168862.69 | JO |
| 16. | Grup i Operatorëve Ekonomik LEDI SH.P.K.; International Security AAH SH.P.K., ramadan rexhepi, 7, ferizaj | 3233 | "Pastrimi I objektit te MSH-së,depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte" | PO | 143700.81 | 169566.96 | JO |

[Në rast se

**Komente nga përfaqësuesit e pranishem**
**Comments from the present authorized representatives of the CA and the EO at the opening of tenders:**
**Komentari prisutnih ovlaštenih predstavnika UA i EO na postupak otvaranja ponuda**

## Përfaqësuesi i OE / EO Representative / Zastupnik EO

| Nr.<br>Br | Tenderuesi, Emri / Mbiemri<br>Tenderer, Name / Surname<br>Tenderer, Ime / Prezime | Nënshkrimi<br>Signature<br>Potpis |
|---|---|---|
| | | |
| | | |

## Komisioni i hapjes / Opening commission / Komisija otvaranja

| Emri Mbiemri<br>Name Surname<br>Ime Prezime | Nënshkrimi/ Signature/ Potpis | Datë/ Date/ Datum |
|---|---|---|
| Alban Thaqi | | 06.03.2026 |
| Besim Bajraktari | | 06.03.2026 |

**Nënshkrimi i Zyrtarit të Prokurimit/ Procurement Officer Signature/ Potpis službenika za javne nabavke:**
Berat Marmullaku

* Procurement officer shall appoint a tender opening commission.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurment Division

## Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm[1]

15.05.2026, Prishtinë

**Ministria e Shëndetësisë** – rr. e Zagrebit nr. 60, ish spitali i mushkërive, lagja Arbëria

**Grup i Operatorëve Ekonomik GUARD DE CAPITAL SH.P.K.; Pro Tech Clean SH.P.K., Rruga B Objekti 2, Hyrja 1 nr 49, 10000, Prishtine**

| | |
|---|---|
| Nr. i prokurimit | **206-26-414-2-1-1** |

Titulli: **"Pastrimi i objektit te MSH-së, depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte"**

I nderuar z. Nergiz Mehmeti,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar tenderin me çmimin më të ulët si përgjigje ndaj njoftimit të kontratës për aktivitetin e prokurimit te lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj ne ofertën e dorëzuar për në vlerë të përgjithshme të ofertës prej **172,041.96 €** dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit te intervalit, gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.

Me respekt,

________ **Berat Marmullaku** ________,
*(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)*

*(Nënshkrimi)*

[1] *Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata*

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurment Division

## B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar[1]

15.05.2026, Prishtinë

**Ministria e Shëndetësisë** – rr. e Zagrebit nr. 60, ish spitali i mushkërive, lagja Arbëria

**Grup i OE CPS Phoenix Group L.L.C.; MEB L.L.C., Edit Durham, 20000, Prizren**

| | |
|---|---|
| Nr. i prokurimit | **206-26-414-2-1-1** |

Titulli: **"Pastrimi i objektit te MSH-së, depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte"**

I nderuar z. Uluaras Damka,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

**ARSYETIM**

Nuk i keni plotësuar kriteret siç janë kërkuar ne NJK dhe DT.

• Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

- Nuk e ka plotesuar kriterin per mjetet e nevojshme te punës, sipas kerkeses nr. 4 te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (9.1 & 9.2) te DT, ku eshte kërkuar qe mjetet te jene ne pronësi te OE dhe nuk eshte parapare me marrveshje te shfrytëzimit – shih dëshminë nga NJK dhe DT: **Dëshmia 4. Dokumentacion për dëshmi te pronësisë se pajisjeve te kërkuara.** OE nuk ka deshmuar qe i posedon mjetet e kerkuara, por ka ofruar nje marrveshje me nje kompani tjeter NTSH "BAM CREATIVE" per shfrytezim te vinçit me qera.

- Analiza financiare nuk eshte bindese per AK dhe nuk mbulon te gjitha kostot reale te parapara me legjislacionin ne fuqi dhe me Vendimin e Qeverise se RK nr. 10273 te datës 31.10.2025 për pagën minimale 500 euro Bruto.

  Nuk i ka perfshire pushimet vjetore sipas Ligjit te Punes nr 03/L-212 neni 32 paragrafi 1. Sipas Ligjit te Punes secilit punetor ne vit i takon pushimi vjetor prej kater jave ose rreth nje muaj, nga kjo rezulton se per nje (1) punetor brenda nje viti shtohet kostoja edhe per 176 ore pune qe duhet te zavendesohet nga nje punetor tjeter. Per shtate (7) punetor perllogaritja eshte

[1] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojës).*

7*176 = 1232 ore pune ne vit jane kosto shtese e pushimeve te punetoreve, e te cilat duhet te mbulohen nga punëtore tjerë. Ndërsa për 3 vite te kontratës përllogaritja eshte 1232*3 = **3696 ore pune te pushimeve.**

Vlera e parashikuar ne Dosje te Tenderit ka qene **180,000.00** Euro , ndërsa oferta Grup i Operatorëve Ekonomik CPS Phoenix Group L.L.C.; MEB L.L.C. ne vlerën **168,171.55** Euro nuk paraqet oferte reale dhe kualitative për realizim.

**Sqarim shtesë:** AK-MSh ka përvoja jo te mira pikërisht me kontratat e shërbimeve te ngjashme (pastrim dhe sigurim fizik) për te cilat kompanitë e kontraktuara me vështirësi po arrijnë qe ti realizojnë obligimet ndaj punëtoreve, andaj konsiderojmë qe një kontrate me çmimin 168,171.55 euro do te ishte e pa favorshme dhe vështirë e realizueshme për te dyja palët.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

________ Berat Marmullaku ________,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

(Nënshkrimi)

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurment Division

## B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar[1]

15.05.2026, Prishtinë

**Ministria e Shëndetësisë** – rr. e Zagrebit nr. 60, ish spitali i mushkërive, lagja Arbëria

**Grup i OE KIGA SH.P.K.; CRYSTAL CLEAR SH.P.K., Sllatine e Madhe, 12000, Fushe Kosove**

| | |
|---|---|
| Nr. i prokurimit | **206-26-414-2-1-1** |

Titulli: **"Pastrimi i objektit te MSH-së, depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte"**

I nderuar z. Ismail Shabani,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

**ARSYETIM**

Nuk i keni plotësuar kriteret siç janë kërkuar ne NJK dhe DT.

• Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

- Nuk e ka plotësuar si duhet Marrëveshjen për Themelimin e grupit, konkretisht nuk i ka plotësuar përgjegjësitë e liderit dhe anëtarit sipas paragrafit 6. pikat a) dhe b).
- Nuk e ka plotësuar kriterin për mjetet e nevojshme te punës, sipas kërkesës nr. 4 te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (9.1 & 9.2) te DT, ku eshte kërkuar qe mjetet te jene ne pronësi te OE dhe nuk eshte parapare me marrëveshje te shfrytëzimit – shih dëshminë nga NJK dhe DT: **Dëshmia 4. Dokumentacion për dëshmi te pronësisë se pajisjeve te kërkuara.** OE nuk ka dëshmuar qe i posedon mjetet e kërkuara, por ka ofruar një marrëveshje me një kompani tjetër DEMOS SHPK për shfrytëzim te mjeteve.

[1] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojës).*

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

_______ **Berat Marmullaku** ________, ______________________
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit) (Nënshkrimi)

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurment Division

## Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm[1]

15.05.2026, Prishtinë

**Ministria e Shëndetësisë** – rr. e Zagrebit nr. 60, ish spitali i mushkërive, lagja Arbëria

**E-Commerce -Kosova SH.P.K., Rr.Luan Haradinaj, 10000, Prishtinë**

| | |
|---|---|
| Nr. i prokurimit | **206-26-414-2-1-1** |

Titulli: **"Pastrimi i objektit te MSH-së, depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte"**

I nderuar z. Atdhe Krasniqi,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj nuk qe tenderi me çmimin më të ulët në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ju informojmë se kontrata i është dhënë **Grup i Operatorëve Ekonomik GUARD DE CAPITAL SH.P.K.; Pro Tech Clean SH.P.K.**, me çmimin e ofertës (me TVSH) **172,041.96 €**.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin e intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

________ **Berat Marmullaku** ________,
*(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)*

________________
*(Nënshkrimi)*

[1] *Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata*

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurment Division

## Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm[1]

15.05.2026, , Prishtinë

**Ministria e Shëndetësisë** – rr. e Zagrebit nr. 60, ish spitali i mushkërive, lagja Arbëria

**GOE ALLTON SH.P.K.; AROMA PLUS SH.P.K., Rruga Muharrem Fejza nr 4, 10000, Prishtine**

| | |
|---|---|
| Nr. i prokurimit | **206-26-414-2-1-1** |

Titulli: **"Pastrimi i objektit te MSH-së, depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte"**

I nderuar z. Aridon Krasniqi,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj nuk qe tenderi me çmimin më të ulët në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ju informojmë se kontrata i është dhënë **Grup i Operatorëve Ekonomik GUARD DE CAPITAL SH.P.K.; Pro Tech Clean SH.P.K.**, me çmimin e ofertës (me TVSH) **172,041.96 €.**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin e intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

________ **Berat Marmullaku** ________,
*(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)*

*(Nënshkrimi)*

[1] *Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata*

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurment Division

## B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar[1]

15.05.2026, Prishtinë

**Ministria e Shëndetësisë** – rr. e Zagrebit nr. 60, ish spitali i mushkërive, lagja Arbëria

**Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë, Rexhep Krasniqi PN, 10000, Prishtin**

| Nr. i prokurimit | 206-26-414-2-1-1 |
|---|---|

Titulli: **"Pastrimi i objektit te MSH-së, depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte"**

I nderuar z. Meriton Bajrami,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

**ARSYETIM**

Nuk i keni plotësuar kriteret siç janë kërkuar ne NJK dhe DT.

- Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

  - Çmimi i ofruar sipas Analizës financiare nuk eshte bindes për AK dhe nuk mbulon te gjitha kostot reale te parapara me legjislacionin ne fuqi dhe me Vendimin e Qeverise se RK nr. 10273 te datës 31.10.2025 për pagën minimale 500 euro Bruto.

    Nuk i ka përfshirë pushimet vjetore sipas Ligjit te Punës nr 03/L-212 neni 32 paragrafi 1. Sipas Ligjit te Punës secilit punëtor ne vit i takon pushimi vjetor prej katër jave ose rreth një muaj, nga kjo rezulton se për një (1) punëtor brenda një viti shtohet kostoja edhe për 176 ore pune qe duhet te zëvendësohet nga një punëtor tjetër. Për shtate (7) punëtor përllogaritja eshte 7*176 = 1232 ore pune ne vit janë kosto shtese e pushimeve te punëtoreve, e te cilat duhet te mbulohen nga punëtore tjerë. Ndërsa për 3 vite te kontratës përllogaritja eshte 1232*3 = **3696 ore pune te pushimeve.**

    Vlera e parashikuar ne Dosje te Tenderit ka qene **180,000.00** Euro , ndërsa oferta Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë ne vlerën **157,704.06** Euro nuk paraqet oferte reale dhe kualitative për realizim.

[1] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojës).*

**Sqarim shtesë:** AK-MSh ka përvoja jo te mira pikërisht me kontratat e shërbimeve te ngjashme (pastrim dhe sigurim fizik) për te cilat kompanitë e kontraktuara me vështirësi po arrijnë qe ti realizojnë obligimet ndaj punëtoreve, andaj konsiderojmë qe një kontrate me çmimin 157,704.06 euro do te ishte e pa favorshme dhe vështirë e realizueshme për te dyja palët.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

_______ **Berat Marmullaku** ________,
*(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)*

________________________
*(Nënshkrimi)*

# KËRKESË PËR RISHQYRTIM

*Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

| Nr 1 i prokurimit | **206-26-414-2-1-1** |
|---|---|

Sa i përket tenderit për: **"Pastrimi i objektit te MSH-së, depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte"**

## 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

*Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë*
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*
*Rr.Rexhep Mala, Nr.25 AKtash*
*(Adresa)*

**Prishtinë**
*(Vendi)*

*10000*
*(Kodi postar)*

*+38349688820*
*(Numri Telefonit)*

*(Numri i Faks-it)*

*Meriton Bajrami*
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*
*efagroupshpk@gmail.com*
*(Adresa elektronike)*

**20.05.2026**
*(Data e parashtrimit të kërkesës)*

*(Nënshkrimi dhe vula)*

DIENSTLEISTUNG GMBH DEGA KOSOVË efagroupshpk@gmail.com efa-dienstleistung.de Rr. Rexhep Mala nr.25/ Aktash, 10000 Prishtinë

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

*(Emri i avokatit)*

*(Adresa e plotë)*

*(Numri i Telefonit)*

*(Numri i faks-it)*

*(Adresa elektronike)*

*(Data e parashtrimit të kërkesës)*

*(Nënshkrimi dhe vula)*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Njoftimi për kontrate 09.02.2026
Hapja e ofertave 06.03.2026
Kërkesa për qasje ne dokumentet e OE-ve 30.03.2026
Qasja ne dokumentet e OE-ve permes Email-it 30.03.2026
Njoftimi mbi rezultatin e aktivitetit te prokurimit 27.03.2026
Vendimi per pranimim e kërkeses per rishqyrtim 14.04.2026
Njoftimi mbi rezultatin e aktivitetit te prokurimit pas rivlersimit 15.05.2026
Kërkesa për qasje ne dokumentet e OE-ve 15.05.2026
Lejimi ne qasje ne dokumentet e OE-ve 18.05.2026

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** [x] **Jo** [ ]

Hapja e ofertave 06.03.2026

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [ ] **Jo** [x]

## 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Ligji nr 04/L-042, i amandamentuar.

Autoriteti Kontraktues (AK) ka shkelur dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, konkretisht:

- Neni 7 – Barazia ne trajtim / Mosdiskriminimi
- Neni 28 – Specifikimet teknike
- Neni 31 – Ekzekutimi i kontratave
- Neni 59 – Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve
- Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

**7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Te nderuar,

Me datën 15.05.2026, juve si Autoritet Kontraktues – Ministria e Shëndetsis, keni publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-se – Formularin B58, ku keni rekomanduar për dhënie te kontratës Grup i Operatorëve Ekonomik GUARD DE CAPITAL SH.P.K.; Pro Tech Clean SH.P.K., Rruga B Objekti 2, Hyrja 1 nr 49, 10000, Prishtine.perderisa ofertën tone e keni eleminimuar me arsyetimin si me poshte:

Ne si OE ankues bazuar ne afatin ligjore te parapare me nenin 108A/A te LPP-se me poshte paraqet kundër argumentet dhe shkeljet ligjore te konsumuara nga ju si AK :

Si perfundim ne si OE, pervec inicimit te procedurave tjera, shkeljet ligjore dhe mos konsistencën e vleresimeve, prandaj, bazuar ne prova dhe dëshmi.

Kundershtojme rivleresimin e bere nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Shëndetsis , pasi konsiderojme se i njejti eshte ne kundershtim me kerkesat dhe kriteret e percaktuara ne Dosjen e Tenderit.

Autoriteti Kontraktues, gjate rivleresimit, ka shtuar elemente dhe pritshmeri te cilat nuk kane qene te percaktuara si kerkesa specifike ne Dosjen e Tenderit, perkatesisht lidhur me menyren e kalkulimit te zevendesimeve te punetoreve gjate pushimeve vjetore. Meqenese nje kerkese e tille nuk eshte parapare qarte ne Dosjen e Tenderit, e njejta nuk mund te perdoret me pas si baze per refuzimin e ofertes sone.

Lidhur me piken 2.3 te Dosjes se Tenderit, sqarojme se kjo dispozite percakton nje obligim te pergjithshem te Ofruesit te Sherbimeve per te siguruar vazhdimesine e sherbimit dhe numer te mjaftueshem te punetoreve gjate gjithe kohes, pavaresisht nga pushimet vjetore, pushimet mjekesore apo obligimet tjera ndaj punetoreve.

Megjithate, kjo pike nuk percakton ndonje metodologji te veçante te kalkulimit financiar, nuk kerkon paraqitjen e nje kalkulimi te posaçem per zevendesime dhe nuk parasheh qe operatori ekonomik duhet te deshmoje ne oferte nje numer shtese te punetoreve per periudhat e pushimeve. Prandaj, Autoriteti Kontraktues nuk mund ta interpretoje kete dispozite si kriter shtese per refuzimin e ofertes, duke pretenduar se oferta jone nuk eshte reale apo kualitative.

Kompania jone ka marre persiper plotesisht obligimin qe gjate gjithe periudhes se kontrates te siguroje punetore te mjaftueshem per realizimin e sherbimeve, perfshire edhe rastet e pushimeve vjetore, pushimeve mjekesore apo mungesave te tjera te punetoreve. Ky obligim eshte pjese e organizimit te brendshem te kompanise dhe nuk nenkupton automatikisht se oferta jone eshte jo-reale apo financiarisht e paqendrueshme.

Theksojme se kompania Efa Dienstleistung GmbH – Dega ne Kosove operon ne treg dhe ofron sherbime te kesaj natyre per institucione publike qe nga viti 2021. Gjate kesaj periudhe, kompania jone ka ofruar sherbime cilesore, ka permbushur me pergjegjesi kontratat e saj dhe nuk ka deshtuar asnjehere ne realizimin e obligimeve kontraktuale apo ne permbushjen e obligimeve ndaj punetoreve.

Prandaj, pretendimi i Autoritetit Kontraktues se oferta jone nuk eshte reale, bindese apo kualitative per realizim, eshte i pabazuar dhe nuk mbeshtetet ne prova konkrete, por ne supozime dhe ne nje interpretim te zgjeruar te Dosjes se Tenderit.

Per keto arsye, kerkojme qe rivleresimi i bere nga Autoriteti Kontraktues te anulohet dhe oferta jone te trajtohet ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne Dosjen e Tenderit, si dhe me parimet e trajtimit te barabarte, transparences dhe mosdiskriminimit te operatoreve ekonomike.

- Neni 7 – Barazia ne trajtim/Mosdiskriminimi

Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundershtim me Nenin 7 te Ligjit per Prokurimin Publik, i cili garanton trajtim te barabarte, jo-diskriminues dhe transparent per te gjithe operatoret ekonomike.

Ne rastin konkret, vendimi i Autoritetit Kontraktues eshte diskriminues, pasi qe eliminon nje operator ekonomik i cili ka permbushur te gjitha kerkesat e percaktuara ne dosjen e tenderit, nderkohe qe shpall fitues nje operator ekonomik tjeter me çmim me te larte.

Ky veprim bie ndesh me parimin e konkurrences se drejte dhe efikasitetit ne shpenzimin e fondeve publike, duke favorizuar padrejtesisht nje operator ekonomik dhe duke demtuar interesin publik.

Per rrjedhoje, kerkojme rishqyrtimin e ketij vendimi dhe rivleresimin e ofertave ne perputhje me parimet themelore te prokurimit publik.

2.1 Neni 28 – Specifikimet teknike

AK eshte i obliguar qe te percaktoje qarte dhe ne menyre te plote te gjitha specifikimet teknike ne dosjen e tenderit.

Ne rastin konkret:

- AK nuk ka parashtruar kerkese per kalkulimin e pushimeve vjetore apo zevendesimeve specifikisht.

Ne Aneksin 1 te dosjes se tenderit eshte kerkuar vetem qe:

"Ofruesi i sherbimeve duhet te kete punetore te mjaftueshem pavaresisht nga obligimet ndaj punetoreve (pushime vjetore, pushime mjekesore, etj.)"

Kjo kerkese:

- Nuk eshte e njejte me kerkesen per kalkulim te pushimeve/zevendesimeve
- Le pergjegjesine tek Operatori Ekonomik per organizimin e brendshem, jo per kalkulim te detyrueshem ne oferte

Ne kemi permbushur kete kerkese permes deklarates perkatese, ashtu siç eshte kerkuar ne dosjen e tenderit.

Kompania jone ka dorezuar deklarate te nenshkruar, me te cilen eshte zotuar se do te permbushe te gjitha obligimet ligjore qe rrjedhin nga Ligji i Punes dhe legjislacioni ne fuqi, perfshire:

pagesen e pagave ne perputhje me pagen minimale

pagesen e kontributeve dhe tatimeve

respektimin e te gjitha obligimeve ndaj punetoreve

Siç deshmohet ne Figuren 1 me poshte, kompania jone eshte zotuar shprehimisht per permbushjen e ketyre obligimeve.

**Për:** Ministria e shëndetsisë
**Lënda:** Pastrimi i objektit të MSH-së, depos së barnave dhe objektit i tri inspektoriateve dhe DSHB në Lakrishte
**Nga:** Kompania efa Dienstleistung GmbH Dega në Kosovë
**Datë:** 06.03.2026, Prishtinë

Kompania jonë deklaron se pajtohet dhe zotohët se do i përmbushë të gjitha kërkesat ligjore të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues Ministria e shëndetsisë për aktivitetin më të dhënat numëri i prokurimit: 206-26-414-2-1-1 me titull: Pastrimi i objektit të MSH-së depos se barnave dhe objektit I tri inspektoriateve dhe DSHB në Lakrishte TË MINISTRISË SHËNDËTSISË.

Kompania jonë deklaron se do ti paguan të gjithë punëtorët konform ligjit të punës në fuqi (jo me pak se 456.50 euro Neto si page minimale e përcaktuar sipas ligjeve në fuqi dhe Vendimit te Qeverise se RK nr. 10273 te datës 31.10.2025), Ofruesi i shërbimeve duhet te lidh kontrate me secili punëtore dhe te kryen pagesën e të gjitha kontributeve në Administratën tatimore të parapara me ligje te Republikës se Kosovës.

Kompania jonë deklaron se punëtoreve do tua paguaj pagën min. 456.50 euro Neto (bazuar ne Vendimin e Qeverise se RK nr. 10273 te datës 31.10.2025 për pagën minimale 500 euro Bruto), si dhe te gjitha kontributet dhe tatimet duke përfshirë edhe TVSH, ne harmoni me Ligjin e Punës në fuqi.

Kompania efa-dienstleistung GmbH-Dega në Kosovë
Meriton Bajrami
Drejtor

2.2 Neni 31 – Ekzekutimi i kontrates

AK mund te vendose kushte per ekzekutimin e kontrates, por:

- keto duhet te jene te perfshira ne dosjen e tenderit

Ne kete rast:

- Edhe pse ka pasur kerkesa per sqarime, AK ne asnje moment nuk ka kerkuar kalkulim te pushimeve
- Ne kemi dorezuar deklaraten per perputhshmeri teknike sipas kerkeses:

"OE duhet te plotesoje deklaraten per perputhje me specifikat teknike ne Aneksin 1"

Eliminimi yne me arsyetimin per mungese kalkulimi:

- eshte i pabazuar dhe ne kundershtim me kerkesat e tenderit

2.3 Standardet e dyfishta

- Autoriteti Kontraktues ka perdorur te njejtat specifikime teknike edhe ne proceduren e prokurimit te vitit 2022, ku ne Aneksin 1 eshte parapare kerkesa:

Ofruesi i sherbimeve duhet te kete punetore te mjaftueshem gjate gjithe kohes, pavaresisht nga obligimet ndaj punetoreve (pushime vjetore, pushime mjekesore, etj.)

Ndryshimi i interpretimit te se njejtes kerkese perben trajtim te pabarabarte dhe standard te dyfishte

Pjese e shkeputur nga dosja e tenderit e vitit 2022:

Kompania jone ka qene fituese ne kete procedure dhe ka realizuar kontraten per nje periudhe 3-vjeçare ne perputhje te plote me kerkesat e AK.

Aneksi 1. **SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

## 1. PASTRIMI I OBJEKTEVE

Autoriteti Kontraktues (Ministria e Shëndetësisë) është duke identifikuar ofruesin e shërbimeve që do të ketë kapacitetin për të kryer shërbimet e pastrimit për Ministrinë e Shendesise.

### 1. SQARIME PËR TERMET E PËRDORURA

Me termin "MIREMBAJTA DHE PASTRIM I OBJEKTIT TE MSH-së" nënkuptohet realizimi i të gjitha punëve të nevojshme lidhur me pastrimet – mirëmbajtjen e higjienës në ndërtese në mënyrë që të përmbushen kërkesat për zbatimin e ligjit mbi mbrojtjen në punë me të cilat duhet krijuar kushtet normale për punë të shfrytëzuesve të hapësirave në kuadër të ndërtesës.

Mirëmbajtja higjienike përfshinë realizimin e punëve për:

- Mirëmbajtjen e pastërtisë në të gjitha hapësirat e brendshme te ndërtesës
- Mirëmbajtjen e shtigjeve të këmbësorëve si dhe të parkingjeve të automjeteve
- Mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara
- Largimin e mbeturinave – nga ndërtesa deri te kontejnerët qendrorë për mbeturina
- Bartjet e materialeve, inventarit etj brenda ne ndërtesa

### 2.PLANI I ORGANIZIMIT TË KRYERJES SË SHERBIMEVE TE PASTRIMIT - OBLIGIMET

2.1 Në planin e organizimit te Ofruesit te shërbimeve duhet patjetër të përfshihet edhe numri minimal i kryeseve të secilit profil, te udhëhequr nga Menaxheri i Ofruesit te shërbimeve.

2.2 Punëdhënësi ka te drejt dhe obligim të kontrolloj dhe kërkoj rritjen e cilësisë se ofruar te shërbimeve dhe nëse vlerëson se me punëtorët aktual nuk arrihet ofrimi i shërbimeve cilesore, Ofruesi i shërbimeve obligohet qe të merr masat e duhura qe te rrit cilësinë e shërbimeve te ofruara.

2.3 Ofrues i shërbimeve gjate gjithë kohës duhet të ketë punëtorë të mjaftueshëm pavarësisht nga obligimet e Ofruesit te shërbimeve ndaj punëtorëve të tij ( Pushime vjetore, pushimet mjekësorë, .......etj. ).

2.4 Ofruesi i shërbimeve për çdo javë do të dorëzoj specifikimin e materialit të shpenzuar për realizmin e shërbimeve.

2.5 Ofruesi i shërbimeve duhet te mbajt historikun për punët e kryera, duke u bazuar në punët e kryera sipas kërkesave, planeve, ditarit të punës dhe ditarin e kujdestarisë.

2.6 Ofruesi i shërbimeve obligohet që dy deri tri ditë para se të filloi muaji i ri përmes shkresës zyrtare të dorëzoi

---

2.4 Neni 59 – Vleresimi i tendereve

Sipas ketij neni:

- Nuk lejohet ndryshimi i kushteve materiale gjate vleresimit

Ne kete rast:

- AK ka vendosur nje kriter te ri (kalkulimi i pushimeve) gjate vleresimit
- Ky kriter nuk ka qene ne dosjen e tenderit

Kjo perben:

- ndryshim te aspektit material te tenderit
- shkelje te drejtperdrejte te ligjit

---

2.5 Neni 60 – Kriteri per dhenien e kontrates

AK ka percaktuar kriterin:

"Tenderi i pergjegjshem me çmimin me te ulet"

Megjithate:

- Oferta jone:
    - ishte me e uleta ne çmim
    - ishte plotesisht e pergjegjshme
    - permbushte te gjitha kerkesat teknike dhe administrative

Pavaresisht kesaj:

- AK ka shpallur fitues nje operator me çmim me te larte

Kjo perben:

- shkelje direkte te Nenit 60

---

3. Argumentet faktike dhe ekonomike

- Kompania jone operon qe nga viti 2020
- Ka realizuar kontrata vetem me institucione publike
- Ka permbushur te gjitha kontratat ne perputhje te plote me kerkesat
- Oferta jone eshte pergatitur ne perputhje te plote me dosjen e tenderit

---

4. Demet materiale

Si rezultat i vendimit te paligjshem, kompania jone ka pesuar:

- Humbje te drejtperdrejta financiare
- Humbje te te ardhurave te pritshme nga kontrata
- Pengim te zhvillimit te aktivitetit ekonomik
- Kosto administrative te pergatitjes se ofertes
- Cenim te konkurrences se ndershme

---

5. Kerkesa (Konkluzioni)

Duke u bazuar ne faktet dhe dispozitat e shkelura, kerkojme:

- Rivleresimin e tenderit ne perputhje me Nenin 60 dhe kriterin "çmimi me i ulet"
- Anulimin e vendimit per eliminimin tone
- Shpalljen e ofertes sone si fituese, ne perputhje me ligjin dhe dosjen e tenderit

---

## 3. Argumentet faktike dhe ekonomike

- Kompania jonë operon që nga viti 2020

- Ka realizuar kontrata vetëm me institucione publike
- Ka përmbushur të gjitha kontratat në përputhje të plotë me kërkesat
- Oferta jonë është përgatitur në përputhje të plotë me dosjen e tenderit

---

**VENDIM**

I. **Te aprovohet** ne tërësi kerkesa për ri shqyrtim si e bazuar
II. **Te kthehet** lënda ne ri vlerësim dhe

Duke u bazuar në faktet dhe dispozitat e shkelura, kërkojmë:

- **Rivlerësimin e tenderit** në përputhje me Nenin 60 dhe kriterin "çmimi më i ulët"
- **Anulimin e vendimit për eliminimin tonë**
- **Shpalljen e ofertës sonë si fituese**, në përputhje me ligjin dhe dosjen e tenderit

**8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Si rezultat i vendimit të paligjshëm, kompania jonë ka pësuar:

- Humbje të drejtpërdrejta financiare
- Humbje të të ardhurave të pritshme nga kontrata
- Pengim të zhvillimit të aktivitetit ekonomik
- Kosto administrative të përgatitjes së ofertës
- Cenim të konkurrencës së ndershme

**9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada - Government*
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurment Division

Prishtine datë, 22.05.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë se Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores per Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas tre **kërkesave për ri-shqyrtim** të parashtruar nga të OE **Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë, CPS Phoenix Group L.L.C., " KIGA " SH.P.K.** te datës 20.05.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Pastrimi i objektit te MSH-së, depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte"** me nr. prokurimi 206-26-414-2-2-1, nxjerr:

## VENDIM

1. **Refuzohen,** si te bazuara kërkesat për ri-shqyrtim të parashtruara nga Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë, CPS Phoenix Group L.L.C., "KIGA" SH.P.K. te datës 20.05.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Pastrimi i objektit te MSH-së, depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte"** me nr. prokurimi 206-26-414-2-2-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK te datës 15.05.2026.

2. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi vendimin e AK i datës 15.05.2026.

3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën: https://e-prokurimi.rks-gov.net .

## Arsyetim

Operatori ekonomik Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë, CPS Phoenix Group L.L.C., "KIGA" SH.P.K. me datën 20.05.2026, kane parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Pastrimi i objektit te MSH-së, depos se barnave dhe objekti i tri inspektorateve dhe DSHB ne Lakrishte" me nr. prokurimi 206-26-414-2-2-1. Autoriteti Kontraktues sot me datën 22.05.2026 i ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

**Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas Efa Dienstleistung**

- Neni 7, 28, 31, 59, 60 i LPP-së

**Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas CPS Phoenix Group L.L.C.**

- Neni 1, 6, 7, 27, 59, 60, 61, 69, 72 të LPP-së
- Shkelje te Rregullores nr. 001/2022 të KRPP-së

**Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas KIGA SH.P.K.**

OE nuk ka pretenduar se AK ka bere shkelje te ndonjë dispozite ligjore.

## Pretendimet ankimore te OE ankues Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë

Kompania jone ka marre persiper plotesisht obligimin qe gjate gjithe periudhes se kontrates te siguroje punetore te mjaftueshem per realizimin e sherbimeve, perfshire edhe rastet e pushimeve vjetore, pushimeve mjekesore apo mungesave te tjera te punetoreve. Ky obligim eshte pjese e organizimit te brendshem te kompanise dhe nuk nenkupton automatikisht se oferta jone eshte jo-reale apo financiarisht e paqendrueshme.

Theksojme se kompania Efa Dienstleistung GmbH – Dega ne Kosove operon ne treg dhe ofron sherbime te kesaj natyre per institucione publike qe nga viti 2021. Gjate kesaj periudhe, kompania jone ka ofruar sherbime cilesore, ka permbushur me pergjegjesi kontratat e saj dhe nuk ka deshtuar asnjehere ne realizimin e obligimeve kontraktuale apo ne permbushjen e obligimeve ndaj punetoreve.

Prandaj, pretendimi i Autoritetit Kontraktues se oferta jone nuk eshte reale, bindese apo kualitative per realizim, eshte i pabazuar dhe nuk mbeshtetet ne prova konkrete, por ne supozime dhe ne nje interpretim te zgjeruar te Dosjes se Tenderit.

Per keto arsye, kerkojme qe rivleresimi i bere nga Autoriteti Kontraktues te anulohet dhe oferta jone te trajtohet ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne Dosjen e Tenderit, si dhe me parimet e trajtimit te barabarte, transparences dhe mosdiskriminimit te operatoreve ekonomike.

- Neni 7 – Barazia ne trajtim/Mosdiskriminimi

Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundershtim me Nenin 7 te Ligjit per Prokurimin Publik, i cili garanton trajtim te barabarte, jo-diskriminues dhe transparent per te gjithe operatoret ekonomike.

Ne rastin konkret, vendimi i Autoritetit Kontraktues eshte diskriminues, pasi qe eliminon nje operator ekonomik i cili ka permbushur te gjitha kerkesat e percaktuara ne dosjen e tenderit, nderkohe qe shpall fitues nje operator ekonomik tjeter me çmim me te larte.

Ky veprim bie ndesh me parimin e konkurrences se drejte dhe efikasitetit ne shpenzimin e fondeve publike, duke favorizuar padrejtesisht nje operator ekonomik dhe duke demtuar interesin publik.

Per rrjedhoje, kerkojme rishqyrtimin e ketij vendimi dhe rivleresimin e ofertave ne perputhje me parimet themelore te prokurimit publik.

2.1 Neni 28 – Specifikimet teknike

AK eshte i obliguar qe te percaktoje qarte dhe ne menyre te plote te gjitha specifikimet teknike ne dosjen e tenderit.

Ne rastin konkret:

- AK nuk ka parashtruar kerkese per kalkulimin e pushimeve vjetore apo zevendesimeve specifikisht.

Kompania jone ka marre persiper plotesisht obligimin qe gjate gjithe periudhes se kontrates te siguroje punetore te mjaftueshem per realizimin e sherbimeve, perfshire edhe rastet e pushimeve vjetore, pushimeve mjekesore apo mungesave te tjera te punetoreve. Ky obligim eshte pjese e organizimit te brendshem te kompanise dhe nuk nenkupton automatikisht se oferta jone eshte jo-reale apo financiarisht e paqendrueshme.

Theksojme se kompania Efa Dienstleistung GmbH – Dega ne Kosove operon ne treg dhe ofron sherbime te kesaj natyre per institucione publike qe nga viti 2021. Gjate kesaj periudhe, kompania jone ka ofruar sherbime cilesore, ka permbushur me pergjegjesi kontratat e saj dhe nuk ka deshtuar asnjehere ne realizimin e obligimeve kontraktuale apo ne permbushjen e obligimeve ndaj punetoreve.

Prandaj, pretendimi i Autoritetit Kontraktues se oferta jone nuk eshte reale, bindese apo kualitative per realizim, eshte i pabazuar dhe nuk mbeshtetet ne prova konkrete, por ne supozime dhe ne nje interpretim te zgjeruar te Dosjes se Tenderit.

Per keto arsye, kerkojme qe rivleresimi i bere nga Autoriteti Kontraktues te anulohet dhe oferta jone te trajtohet ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne Dosjen e Tenderit, si dhe me parimet e trajtimit te barabarte, transparences dhe mosdiskriminimit te operatoreve ekonomike.

- Neni 7 – Barazia ne trajtim/Mosdiskriminimi

Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundershtim me Nenin 7 te Ligjit per Prokurimin Publik, i cili garanton trajtim te barabarte, jo-diskriminues dhe transparent per te gjithe operatoret ekonomike.

Ne rastin konkret, vendimi i Autoritetit Kontraktues eshte diskriminues, pasi qe eliminon nje operator ekonomik i cili ka permbushur te gjitha kerkesat e percaktuara ne dosjen e tenderit, nderkohe qe shpall fitues nje operator ekonomik tjeter me çmim me te larte.

Ky veprim bie ndesh me parimin e konkurrences se drejte dhe efikasitetit ne shpenzimin e fondeve publike, duke favorizuar padrejtesisht nje operator ekonomik dhe duke demtuar interesin publik.

Per rrjedhoje, kerkojme rishqyrtimin e ketij vendimi dhe rivleresimin e ofertave ne perputhje me parimet themelore te prokurimit publik.

2.1 Neni 28 – Specifikimet teknike

AK eshte i obliguar qe te percaktoje qarte dhe ne menyre te plote te gjitha specifikimet teknike ne dosjen e tenderit.

Ne rastin konkret:

- AK nuk ka parashtruar kerkese per kalkulimin e pushimeve vjetore apo zevendesimeve specifikisht.

Ne Aneksin I te dosjes se tenderit eshte kerkuar vetem qe:

"Ofruesi i sherbimeve duhet te kete punetore te mjaftueshem pavaresisht nga obligimet ndaj punetoreve (pushime vjetore, pushime mjekesore, etj.)"

Kjo kerkese:

- Nuk eshte e njejte me kerkesen per kalkulim te pushimeve/zevendesimeve
- Le pergjegjesine tek Operatori Ekonomik per organizimin e brendshem, jo per kalkulim te detyrueshem ne oferte

Ne kemi permbushur kete kerkese permes deklarates perkatese, ashtu siç eshte kerkuar ne dosjen e tenderit.

